



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Kryesia e Kuvendit

P-023

Prishtinë, më 14 mars 2018, në orën 18:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I Mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 14 Mars 2018

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Kujtim Shala, Aida Dërguti, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Albulena Haxhiu, Memli Krasniqi, Dardan Sejdiu, Teuta Haxhiu, Sasha Milosavljeviq, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Avni Bytyçi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha dhe

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

1. Njoftimi për formimin e grupit të ri parlamentar “Grupi i Deputetëve të Pavarur”- GDP

Kryetari i njoftoi të pranishmit se e ka pranuar një njoftim nga 12 deputetë, të cilët më herët kanë qenë anëtarë të GP të LVV, por që në të ardhmen kanë vendosur ta formojnë një grupi i ri parlamentar “Grupi i Deputetëve të Pavarur”- GDP.

Kryearti e hapi diskutimin.

Lidhur me njoftimin për formimin e grupit të ri parlamentar diskutuan Albulena Haxhiu dhe Dardan Sejdiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pasi diskutoi në lidhje me formimin e grupit të ri parlamentar “Grupi i Deputetëve të Pavarur”, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Grupi i ri parlamentar “Grupi i Deputetëve të Pavarur” përbëhet nga dymbëdhjetë (12) deputetë të Kuvendit, kryetar i grupit është deputeti Dardan Sejdiu, sipas njoftimit për formimin e grupit të ri parlamentar, nr. 06/870 Do-528, datë 14. 3. 2018.

2. Grupit parlamentar “Grupi i Deputetëve të Pavarur” i takojnë këto të drejta:

2.1 Zyra për akomodimin e grupit parlamentar,

2.2 Një (1) asistent administrativ, i cili paguhet nga buxheti i Kuvendit të Kosovës,

2.3 Këshilltar politik-profesional, sipas vendimit të Kryesisë së Kuvendit për lejimin e stafit mbështetës politik profesional për grupin parlamentar, nr. 06-V-074, datë 5 shkurt 2018, të cilët paguhet nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Gjithashtu, ndarja e kryesimit të komisioneve parlamentare dhe përfaqësimi i tyre në këto komisione nga GP i LVV dhe GP i “Deputetëve të Pavarur” të bëhet në marrëveshje ndërmjet tyre, si dhe për mbledhjen e radhës të Kryesisë së Kuvendit t’i paraqesin propozimet konkrete për t’i proceduar në seancë plenare.

Pika shtesë:

1. Kërkesa e OJQ-së “Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave” në Drenas për mbështetje financiare

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori edhe këtë:

V E N D I M

1. OJQ-ja “Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave - QPDG”, në Drenas, mbështetet financiarisht në shumën prej 4 995 euro për financimin e projektit të tyre “Fuqizimi i grave viktime të dhunës seksuale gjatë luftës (VDhS) dhe ngritja e kapaciteteve të VDhS”.
2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të OJQ-së “Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave - QPDG”, me nr. 1189005858000150, në bankën ProCredit Bank.

* * *

Në fund, Kryesia vendosi që intervistimi i kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës të bëhet më 16 mars 2018, duke filluar nga ora 9:00.

Kryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 18:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit:

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale